REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 365
Data/Datum 17. 11. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 27.08.2026, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani – Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Burim Berisha, Rrahim Tërrnava, Valon Murseli, Ermal Dumani, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Aida Alimi, Suhat Ademi, Dashnim Bajrami, Driton Ademi, Gjelbrim Halili, dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Etnik Berjani dhe Ali Ismaili.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Bardhyl Koiçiçi - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Albana Gashi - Drejtoresha për Shëndetësi, Durim Hajra - Drejtor i Inspeksionit, Izja Mjeku - Drejtor i Shërbimeve Publike.

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile.

REND DITE

1. Propozim për shqyrtimin e parë të ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapim zyrtarisht mbledhjen e jashtëzakonshme, faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen, është shumë e nevojshme dhe urgjente, njoftimet i keni marrë me kohë, materialin e keni pranuar besoj, që keni pasur kohë të mjaftueshme për konsultim të materialit. Mbledhja e ka vetëm një pikë të rendit të ditës: Propozimi për shqyrtimin e parë të ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Adiministratën Komunale. Duke parë rëndësinë e kësaj Rregulloreje dhe planifikimet buxhetore, për vitet e ardhshme, duke u bazuar në këtë Rregulloren për mbarëvajtjen e punës së Administratës Komunale, propozohet për shqyrtimin e parë të Projekt-Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 145/24 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale. Unë po e lexoj para juve materialin për thirrje e mbledhjes për shqyrtimin e Projekt-Rregullores për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 145/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale, e cila është përgatitur nga Grupi Punues i formuar me vendimin e Kryetarit të Komunës, me Nr. 856, të datës 04.06.2026 dhe Drejtorëve të Drejtorateve të Komunës në përputhje me rregullativën e fushës, e cila buron nga Ligjin Nr. 08/L-197, për zyrtarët publik, Ligji Nr. 03/L-040 për

Vetëqeverisje Lokale dhe Statuti i Komunës, që garanton pavarësinë dhe të drejtat e zhvillimit lokal në përputhje me përgjegjësinë dhe kompetencat e pushtetit lokal. Në këtë Projekt-Rregullore përcaktohen kompetencat e drejtorive dhe përgjegjësitë shtesë, sektorëve, njësive dhe zyrave, andaj propozojmë në shqyrtimin e parë 'Projekt-Rregulloren për ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 145/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale dhe propozimit i bashkangjitet materiali përcjellës. Konstatojmë që kemi korumin e mjaftueshëm dhe e qesim në votim këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim.
U votua me shtatëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje gjithsej njëzet e një anëtarë. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u miratua rendi i ditës.

Pika e parë (1) - Propozim për shqyrtimin e parë të ndryshim-plotësimit të Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Materialin e keni para juve, unë po i lexoj orientimet që janë bërë në këtë propozim, është Kabineti i Kryetarit të Komunës që ndahet, pastaj me pozitat e nëpunësve civil me Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Sektori për Çështje Ligjore, Sektori për Komunale Komunitete dhe Kthim, Zyra për Komunikim me Publikun, Njësia për Auditim të Brendshëm, Sektori për Planifikim Strategjik, Drejtori e Administratës dhe Shërbime të Përbashkëta me sektorët e saj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Shëndetësi, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, Drejtoria për Kulturë, Drejtoria për Rini dhe Sport, Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Pronë, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menagjim të Kontratave, Drejtoria për Inspektorat, Drejtoria për Emergjenca dhe Drejtoria e Parqeve. Shpresoj që të kalon kjo Rregullore në lexim të pare, pastaj mund të jepni kontibutin tuaj në diskutime publike ose në lexim të dytë, po e hapim diskutimin.

Kosovar Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Deri tani mendojmë se ka pasur pozita me vendime, të cilat kanë qenë të shpikura, konsiderojmë që më këtë organogram, do të rregullohet kjo pjesë, me ndarjen e drejtorive të cilat do të jenë funksionale dhe formimin e një drejtorie të re, ajo e parqeve. Në secilin drejtori, sector apo njësi, ku ka nevojë do të ketë rritje të stafit dhe për këtë arsye, ne e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e parë 'Projekt-Rregulloren për ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 145/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale'.

Migjen Kolshi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Kryesues I Kuvendit të Komunës, sipas nenit 31, mbledhja e jashtëzakonshme thirret 3 ditë pune para mbledhjes dhe për caktohet mënyra se si duhet të njoftohen asambleistët dhe qytetarët, është e vërtetë që na keni njoftuar përmes viberit, por për mua nuk ka pasur viber, kur është bërë kjo, njoftimi është dashur të jetë në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe me sa e di unë nuk ka qenë, këtë herë nuk është respektuar afati për thirrje të mbledhjes së Kuvendit. Sa i përket pikës së rendit të ditës, ai që e ka

thirrë këtë mbledhje nuk është i pranishëm në mbledhje, pra Kryetari i Komunës është dashur të jetë prezentë dhe të na elaboron këtë propozim, për këtë organizim të brendshëm të komunës, ne nuk e kemi koston financiare, në çka është bazuar Kryetari i Komunës për të formuar Drejtori të reja, ne si Grup Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës, nuk e përkrahim këtë propozim për ndryshim, sepse e shohim si jo të arsyeshme rritjen e numrit të Drejtorateve të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kolegë i nderuar një sqarim për arsye të korrektësisë, ajo që ju theksuat se është bërë ftesa në viber, po ju rikujtoj nenin 44, për takime të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, pika 44.4, po e lexoj: *Takim i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës, nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim siç kërkohet me Rregullore të Punës, tre ditë pune para mbajtjes së takimit.* Ju jeni njoftuar ditën e hënë për të enjten dhe në bazë të kësaj, ne jemi në rregull, sa i përket afatit ligjor. Sa i përket pjesës për kosto financiare dhe mos prezencën e Kryetarit të Komunës që ju thatë, sipas kërkesave të Drejtorive Komunale përcaktohen kompetencat e drejtorive dhe përgjegjësitë shtesë të komunës, sektorëve, njësive dhe zyrave, ky është arsyetimi real, shumë i nevojshëm dhe domosdoshëm, në bazë të kësaj është bërë ky propozim e që do të vazhdojë, deri në leximin e dytë dhe do të diskutojmë të gjitha detajet.

Migjen Kolshi: Kryesues i Kuvendit të Komunës, a ka ndodhur ndonjëherë të mbahet mbledhja e jashtëzakonshme, pa prezencën e atij që e ka thirrë mbledhjen?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nuk e di a ka ndodhur por prezentë kemi një numër të drejtorëve, ju i dini kompetencat që i jep ligji Kryetarit të Komunës, drejtorët janë prezentë dhe janë pjesë e Grupit Punues, që janë marrë me hartimin e këtij propozimi.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë, ne çfarë do forme që mbërrin informata për mua është e pranueshme. Kjo pikë e rendit të ditës i ka dy kaptina: organizimi i funksionit të brendshëm dhe pjesa e sistematizmit të vendeve të punës, është diçka që po përsëritet, sepse vetëm 4-5 komuna në Kosovë, jemi duke shkuar me këtë lloj Rregullore, do të duhet të shkojmë me ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës, por kjo qeverisje e ka paraparë organizimin në këtë mënyrë. Unë e përkrah këtë propozim, ka disa drejtori të reja dhe disa janë plotësuar, është në lexim të parë dhe shpresoj të keni kujdes më kategorizimin e shërbyesve civil, sepse ka shërbyes që kanë përvojë dhe kontribuojnë në funksionimin e Ekzekutivit të Komunës dhe interesit publik. Është mirë që Ekzekutivi i Komunës, të na elaboroj këtë propozim siç tha dhe Migjen Kolshi, mirëpo është në shqyrtimin e parë dhe shpresoj që do të kemi kohë.

Valon Murseli: Përshëndetje për të gjithë të pranishëm në mbledhje. Ne si Grup Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, nuk e përkrahim këtë ndryshim të Rregullores për disa arsye, me këtë Rregullore rritet numri i drejtorive që sipas neve është e panevojshme, rritet numri i sektorëve që është e panevojshme, rritet numri i pozitave të punës për 28 vende të reja pune në raport me Rregulloren e vitit 2024 dhe për këto ndryshime, besoj që duhet të kemi një 'Plan vjetor të personelit me planifikimin buxhetor', i cili duhet të përmbajë analizën e nevojave dhe afatet e plotësimit të këtyre pozitave sipas Ligjit për Zyrtarët Publik neni 17, duhet të kemi dëshmi se respektohet tavani i pagave dhe vendimi për rritjen e ndarjes në kategorinë ekonomike 'Paga dhe Mëditje', sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike neni 30, pika 5. Kryesues i Kuvendit

të Komunës, më bëri përshtyje e tërë ajo reklamë për këtë mbledhje të jashtëzakonshme, që ishte ndoshta për të humbur vëmendje se më këtë Rregullore po bëjmë diçka të mirë, por duhet të informojë qytetarët më saktë, sepse me këtë Rregullore po rritet numri i Drejtorive, po rritet numri i sektorëve, po rritet numri i pozitave, pra është e nevojshme të dime, nëse ky sistematizim do të plotësohet me stafin aktual apo do të plotësohet me rritje të numrit të vendeve të reja të punës dhe nëse i kemi edhe 28 pozita të reja, kostoja financiare do të jetë 270,000.00€, vjetore sipas koeficientëve që keni paraqitur në dokumentin e kësaj Rregullore. Pra, po rrisim shpenzimet kur të hyrat vetjake kanë rënë për 577,000.00€, në përiudhën Janar-Qershor 2026, krahasuar me vitin 2025, ku shpenzimet tek kategoria ekonomike e 'Mallërave dhe Shërbimeve' janë rritur për 724,000.00€, ku shpenzimet komunale janë rritur për 194,000.00€, ku me këtë Rregullore parashihen të krijohen drejtori të reja, si ajo e parqeve, që për mua është dublikifim i Ndërmarrjes Publike Lokale, që e kemi formuar si Kuvend i Komunës. Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport po e ndajmë në dy drejtori, gjithashtu edhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, po e ndajmë në dy drejtori. Mendojmë, që më mirë do të ishte që kjo mbledhje të ishte thirrur për t'i ndihmuar prindërit që kanë fëmijët në kopshte private ose për menaxhim te problemit të mbeturinave që po e ngulfatin qytetin, apo për transportin e udhëtarëve, që kanë mbetur keq për dhjetë ditë. Kërkojmë të dimë te Drejtoria e Parqeve që janë 8 pozita dhe 8 pozita te Drejtoria për Rini dhe Sport, a do të hapen konkurse të jashtme apo do të bëhet bartje e stafit ekzistues, koston e saktë vjetore për këto pozita shtesë, planin e rekrutimit me afate kohore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Valon Murseli, me rritjen e numrit të banorëve në komunën tonë, rritet kërkesa e tyre për shërbime dhe numri i stafit në administratë dhe tavanin e stafit e vendos Ministria, jo ne. Ju thatë që është rritur kostoja e pagesës së këtyre punëtorëve dhe prapë qëndron arsyetimi i njejtë, kur rritet stafi në administrate, rritet kostoja e shpenzimeve. Sa i përket kopshteve private për mbështetje nuk jemi kundër tyre, por shumë më mirë do të ishte të rritet numri i kopshteve publike, po shpresojmë të kemi sa më shumë fëmijë dhe t'i plotësojmë kushtet e tyre. Meqenëse nuk ka diskutime të tjera po e qesim në votim për aprovim në shqyrtimin e parë dhe kalimin në procedurën e diskutimit publik të 'Propozimit për ndryshim-plotësimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale'. U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', katër vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej njëzet e një anëtarë. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi në shqyrtimin e parë dhe kalimin në procedurën e diskutimit publik të 'Propozimit për ndryshim-plotësimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin në parim për procedurën e diskutimit public të ndryshim-plotësimit të Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:00h.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani